

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6885  
E mërkurë, 3 maj 2023  
Çmimi 0.40 €

## Miratohet në Bruksel Deklarata për të Zhdukurit, opozita në Kosovë thotë se Kurti bëri lëshime

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)




facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# KMDLNJ NUMËRON SHKELJE TË SHUMTA TË GJYKATËS SPECIALE

FAQE 4-5



PHIL NINHUE (EPA-EFE)

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka thënë se Gjykata Speciale është jashtë çdo mbikëqyrjeje të ndonjë organizate për të drejtat e njeriut prandaj, "vetë prenë dhe vetë qepë, pa i dhënë llogari askujt". Sipas KMDLNj-së, redaktimi i madh i aktakuzave dhe

dëshmime e bën tërë procesin jotransparent dhe, thuajse, edhe sot është i pamundur të bëhet monitorimi i procesit gjyqësor përmes mjeteve elektronike. KMDLNj thekson se Specialja ka bërë përpjekje maksimale t'i denigrojë të paraburgosurit para opinionit me

deklarata të papërgjegjshme të ish-prokurorit Smith sikur edhe me rastin e caktimit dhe të vazhimit të paraburgimit. "Merren parasysh provat e sajara nga shërbimi informativ dhe kundërinformativ i Serbisë si dhe dëshmitarët e trajnuar në Serbi", thuhet në shkrimin e KMDLNj-së

## PËRKUJTOHET MASAKRA E STUDIMES, ATY KU POLICIA DHE USHTRIA SERBE MASAKRUAN 116 CIVILË TË PAFAJSHËM

FAQE 3



## KUNDËRSHTOHET HEQJA E EMRIT TË HASAN PRISHTINËS NGA UP-JA, KËRKOHET TË TËRHIQET REKTORI

FAQE 5



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

## AKTUALE



## SHBA-ja MUND TË MBETET PA PARA PAS NJË MUAJI

F. 2

## GIZ-i I DORËZON MSH-SË PAJISJE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE MJEKËSORE MBI 208 MIJË EURO

F. 6

## INFLACIONI NË EVROPË RRIET PARA VENDIMIT PËR NORMËN E INTERESIT

F. 5



## EKONOMI



## MOSPAGESA E TATIMIT NË PRONË, IBRAHIMI: QYTETARËT DO TË GJOBITEN ME KAMATA DHE NDËSHKIME NGA MINISTRIA E FINANCEVE

F. 8

## SPORT



## KOSOVA MËSON KUNDËRSHTARËT NË LIGËN E KOMBEVE

F. 10

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Miratohet në Bruksel Deklarata për të Zhdukurit, opozita në Kosovë thotë se Kurti bëri lëshime

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 2 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kanë miratuar të martën në Bruksel Deklaratën për të Zhdukurit.

Shefi i diplomacisë së BE-së, Josep Borell, ka thënë se kanë mirëpritur miratimin e deklaratës lidhur me personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë.

Pas miratimit, Borell ka thënë se dy palët janë zotuar gjithashtu të bien dakord për detajet operacionale në takimin e ardhshëm të dialogut që pritet të mbahet në nivel të kryenegociatorëve. "Zgjidhja e çështjes së personave të zhdukur nuk është vetëm një detyrim humanitar. Ai është gjithashtu një mundësi thelbësore për pajtimin dhe besimin mes njerëzve. BE-ja mirëpret miratimin e deklaratës nga palët dhe pret që palët të bëjnë përparim të prekshëm në mbylljen e rasteve të pazgjidhura të Personave të Zhdukur dhe në përmbushjen e detyrimeve të tyre përkatëse ndaj familjeve", u tha në deklaratën e Borellit.

Përfaqësues nga opozita në vend, kanë thënë se me këtë deklaratë Kosovës iu bën edhe dy dëme të pariparueshme nga Albin Kurti. "1. Kosova u barazua me Serbinë, duke u trajtuar si dy palë të barabarta në krimet që janë kryer në vendin tonë. 2. Pranimi i termit persona 'të zhdukur me forc' në vend të atij 'të zhdukur me dhunë' (që është term juridik i pranishëm në konventat kundër krimeve të luftës), shfaqëson Serbinë si shtet nga përgjegjësia për zhdukjen e personave të pagjetur. Asnjë fitore për Kosovën. Veç degradim. Veç koncesione. Dhe filma për qytetarët e vendit tonë", ka shkruar në "Facebook" kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj.

Edhe deputetja e PDK-së, Blerta Deliu, ka theksuar se deklarata për të zhdukurit e pranuar nga kryeministri Kurti shfaqëson përgjegjësinë e shtetit të Serbisë dhe barazon krimet e Serbisë dhe Kosovës.

Gjithashtu edhe profesori universitar, Blerim Latifi, ka thënë në emisionin Pressing në T7 se një fjalë në tekstin e Deklaratës për Personat e Zhdukur është problematike për shtetin e Kosovës. Latifi, duke komentuar marrëveshjen, tha se largimi i fjalës "persona të zhdukur me dhunë" është fitore për Serbinë.

Ish-kryesuesi i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, ka thënë në emisionin Pressing në T7 se "është tmerruar" kur e pa Deklaratën për Personat e Zhdukur të dakorduar në Bruksel në mes të Kosovës dhe të Serbisë. Hasani thotë se ajo ka dy probleme në dokumentin e



nënshkruar. E para është se Kosova barazohet me Serbinë, ndërsa e dyta është se Kosova nuk ka ekzistuar si shtet para 2008-s dhe nuk mund të marrë përgjegjësi për atë se çfarë ka ndodhur. "Në aspektin ndërshtetëror ajo deklaratë ka dy defekte jashtëzakonisht serioze pasi më ka çudit nga ata që eventualisht mund ta këshillojnë Kurtin, po flas për vendorët jo për ndërkombëtarët. Ajo që quhet zhdukje me forcë, po e shoh që menjëherë ka filluar barazimi me gjuhën shqipe. Me këtë është larguar çdo përgjegjësi e shtetit serb për këtë kategori të personave. E dyta, do të thotë, është çështja palët që i kanë në posedim provat e tyre. Kjo është e pakuptimtë. Kosova është ndërtuar si shtet, siç thotë një studiues britanik, në natën e 17 shkurtit 2008. Deri atëherë në Kosovë ka ekzistuar administrata e UNMIK-ut. Si mund të jep përgjegjësi Kosova për një periudhë kur nuk ka ekzistuar", shtoi Hasani.

Pas miratimit të Deklaratës për Personat e Zhdukur ka reaguar edhe presidentja Vjosa Osmani, e cila ka thënë se fati i të zhdukurve me forcë ka qenë prej kohësh një plagë e thellë në shoqërinë tonë. "Familjet që vazhdojnë të kërkojnë vendndodhjen e të dashurve të tyre, të cilët u zhdukën me forcë nga regjimi i Millosheviqit dhe përmes një sistemi të krimeve të luftës dhe gjenocidit të sponsorizuar nga shteti, kanë mbi dy dekada që mbajnë këtë barrë të rëndë në zemrat dhe në emër të një vendi të tërë. Atyre u është mohuar në mënyrë çnjerëzore drejtësia dhe paqja për një kohë të gjatë. Shpresojmë që deklarata e rënë dakord sot në Bruksel do të hapë rrugën për njohjen e këtyre krimeve dhe për drejtësinë. Por mbi të gjitha, një moment lehtësimi për familjet që kanë pësuar dhimbje dhe vuajtje të pashpjegueshme. Kjo deklaratë do të kërkojë zbatim të menjëhershëm dhe për këtë, siç e

dimë nga marrëveshjet e mëparshme, Serbia ka një histori të paimagjinueshme", ka shkruar Osmani në "Tëitter".

## Deklarata për të Zhdukurit e arritur në Bruksel:

Duke theksuar rëndësinë e zgjidhjes së fatit të personave që vazhdojnë të mbeten të zhdukur dhe për të nxitur pajtim dhe paqe të qëndrueshme; Duke pasur parasysh se kjo Deklaratë ndjek mirëkuptimin e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK) për Personat e Zhdukur, që përfshin personat e zhdukur me forcë; Duke kujtuar se të gjitha kategoritë e personave të zhdukur, do të trajtohen me prioritet të barabartë; Duke njohur punën e rëndësishme të bërë përmes Grupit Punues për Personat e Zhdukur, i kryesuar nga KNKK; Duke inkurajuar bashkëpunimin me aktorë të tjerë relevantë në

fushën e personave të zhdukur, në veçanti me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP); Duke e njohur çështjen e personave të zhdukur si çështje humanitare; Duke vënë në dukje nevojën urgjente për përpjekje shtesë për të lehtësuar vuajtjet e familjeve; Ne angazhohemi bashkërisht; Për të siguruar zbatimin e plotë të angazhimeve përkatëse në fushën e personave të zhdukur; Për të bashkëpunuar ngushtë për identifikimin e vendeve të varrimit dhe për të pasuar më pas me gërmime; Për të siguruar qasjen e plotë në informacione të besueshme dhe të sakta që ndihmojnë të gjenden dhe identifikohen personat e zhdukur brenda periudhës kohore 1 janar 1998 - 31 dhjetor 2000. Kjo përfshin të gjitha materialet, shënimet, urdhrat, dokumentet, videot, audio-incizimet dhe çdo dokument tjetër - përfshirë edhe ato që kanë statusin e klasifikuar - nën posedimin e institucioneve të të

dyja palëve, që janë të rëndësishme për këtë kontekst; Për t'i vënë në dispozicion të gjitha dokumentet vendore dhe ndërkombëtare me rëndësi për përcaktimin e fatit të personave të zhdukur, për të përdorur të dhënat satelitore, LIDAR dhe teknologji tjera, në zbulimin e varreve masive; Për të mundësuar dhe inkurajuar angazhimin aktiv të familjeve të personave të zhdukur në procesin e identifikimit të fateve të tyre; Për të siguruar në mënyrë adekuatë të drejtat dhe për të adresuar nevojat e familjeve të personave të zhdukur; Për të krijuar dhe punuar së bashku përmes një Komisioni të Përbashkët, të kryesuar nga Bashkimi Evropian dhe të vëzhguar nga KNKK, me qëllim të mbështetjes së përpjekjeve për të zgjidhur fatin e personave që mbeten të zhdukur; Për të monitoruar dhe mbështetur punën dhe progresin e bërë nga Grupi Punues për Personat e Zhdukur përmes Komisionit të Përbashkët.

## Borrell: Draft-statuti për Asociacionin, pikënisje e negociatave

Takimi i Kurtit me Vuçiqin ka vazhduar edhe për temën e dytë, atë të asociacionit të komunave me shumicë serbe. Shefi i politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Joseph Borrell, tha se Kosova dhe Serbia "morën një hap simbolik" drejt themelimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë. "Sot, Ekipi Menaxhues prezantoi draftin fillestar [për statutin e këtij asociacioni]", tha Borrell para gazetarëve. Ai ndërmjetësoi të martën një raund të ri të bisedimeve midis kryeministrit të

Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Një nga pikat e rendit të ditës ishte paraqitja dhe diskutimi i draft-statutit për formimin e Asociacionit. Ky dokument u paraqit nga Ekipi Menaxhues, që përbëhet prej katër pjesëtarëve të komunitetit serb, përfshirë edhe një deputete të Kuvendit të Serbisë. "Pikëpamjet e palëve janë shumë të ndryshme për natyrën e këtij Asociacioni. Nuk kam pritur gjë tjetër. Unë kam qenë i sigurt se palët kanë pikëpamje të

ndryshme, por edhe nëse nuk janë pajtuar, ato kanë rënë dakord për t'i filluar negociatat për të ardhmen e Asociacionit", tha Borrell.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, tha se Kosova "nuk do ta përmbushë obligimin e saj të dhjetë vjetëve më parë" për formimin e Asociacionit.

"Unë dua t'i nxis të dyja palët që të angazhohen në këtë proces në mënyrë konstruktive dhe me mirëbesim dhe të jenë të gatshme për të arritur kompromise", shtoi ai.

## ShBA: Mbi 20 000 luftëtarë rusë të vrarë në Bahmut



**WASHINGTON, 2 MAJ** - Shtëpia e Bardhë beson se më shumë se 20 000 luftëtarë rusë janë vrarë në betejën për qytetin ukrainas të Bahmutit në pesë muajt e fundit. Rreth 80 000 të tjerë janë plagosur, tha zëdhënësi i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, John Kirby, duke u thirrur në informacione të deklasifikuara të inteligjencës. Gjysma e të vrarëve janë nga grupi privat mercenar, Wagner, tha ai. Nëse është i saktë, numri i

viktimave ruse tejkalon popullsinë e qytetit të Bahmutit përpara luftës, që përbëhej prej rreth 70 000 banorësh. Moskë po përpiqet ta marrë kontrollin e Bahmutit që nga viti i kaluar. Beteja për qytetin e vogël - ku kanë mbetur vetëm disa mijëra civilë - ka marrë një rëndësi të madhe simbolike për të dyja palët. Zyrtarët ukrainas kanë thënë, po ashtu, se janë duke e shfrytëzuar betejën për të vrarë

sa më shumë trupa ruse dhe për t'i zvogëluar rezervat e tyre. Megjithatë, Ukraina kontrollon tani vetëm një pjesë të vogël të këtij qyteti. "Përpjekja e Rusisë për një ofensivë në Donbas, kryesisht përmes Bahmutit, ka dështuar. Rusia nuk ka arritur të kapë ndonjë territor me rëndësi të vërtetë strategjike", u tha Kirby gazetarëve. "Ne vlerësojmë se Rusia ka pësuar më shumë se 100 000 viktime, duke përfshirë mbi 20 000 të vrarë", theksoi ai.

## ShBA-ja mund të mbetet pa para pas një muaji

**WASHINGTON, 2 MAJ** - Sekretarja amerikane e Thesarit, Janet Yellen, paralajmëroi se ShBA-ja mund të mbetet pa para deri më 1 qershor, nëse Kongresi nuk arrin ta rrisë tavanin e borxhit. Arritja e tavanit të borxhit do të thotë se qeveria nuk mund të marrë më shumë para hua. Yellen i kërkoi Kongresit të veprojë "sa më shpejt që të jetë e mundur" për ta adresuar tavanin prej 31.4 trilionë dollarësh. Presidenti Joe Biden thirri një takim të udhëheqësve të Kongresit për këtë çështje më 9 maj. Tavanin i borxhit është rritur, zgjatur ose rishikuar 78 herë në ShBA që nga viti 1960. Në këtë rast, republikanët e Dhomës së Përfaqësuesve kanë kërkuar

shkurtime drastike të shpenzimeve dhe ndryshimin e disa aspekteve të agjendës së Bidenit - duke përfshirë programin e tij të faljes së huave studentore dhe kreditë e taksave të energjisë së gjelbër - në këmbim të votave për ta rritur tavanin e borxhit. Kjo ka nxitur kundërshtimin e demokratëve në Senat dhe të vetë Bidenit, i cili ka thënë, javën e kaluar, se çështja "nuk është e negociueshme". Presidenti, megjithatë, është nën presion në rritje nga grupet e biznesit për t'i diskutuar propozimet e republikanëve. Falimentimi, i cili do të ishte i pari në historinë e ShBA-së, do të mund t'i përmbyste tregjet financiare globale dhe ta shkatërronte besimin të ShBA-ja



si një partnere globale biznesi. Ekspertët kanë paralajmëruar, po ashtu, se falimentimi mund ta çojë ShBA-në në recesion dhe

të shkaktojë rritje të papunësisë. Kjo, gjithashtu, do të bënte që ShBA-ja të mos mund të marrë para hua për t'i paguar pagat e

punonjësve të qeverisë dhe personelit ushtarak, kontrollat e sigurimeve sociale ose detyrime të tjera.

## "Babai" i inteligjencës artificiale jep dorëheqje



**NYU-JORK, 2 MAJ** - Personi që shihet gjerësisht si "baba" i inteligjencës artificiale ka lënë punën dhe ka paralajmëruar për rreziqet në rritje nga zhvillimet në këtë fushë. Geoffrey Hinton, 75 vjeç, ka njoftuar dorëheqjen e tij nga Google përmes një shkrimi për gazetën "New York Times", duke thënë se tani i vjen keq për punën e tij. Duke folur për BBC-në, ai ka thënë se disa nga programet e inteligjencës artificiale janë "mjaft të frikshme". "Aktualisht ato nuk janë më inteligjente se ne - me

sa mund të them. Por, mendoj se së shpejti mund të jenë", ka thënë Hinton. Ai ka thënë se edhe moshë e tij ka luajtur rol në vendimin për t'u tërhequr nga giganti i teknologjisë. "Jam 75 vjeç, kështu që është koha të tërhiqem", ka thënë Hinton. Në shkrimin e tij për gazetën "New York Times", Hinton u është referuar "aktorëve të këqij", të cilët mund të përpiqen ta përdorin inteligjencën artificiale për "gjëra të këqija". Kur është pyetur nga BBC-ja për ta elaboruar këtë, ai është

përgjigjur: "Ky është thjesht një lloj i skenarit më të keq, një skenar makthi". "Mund ta imagjinoni, për shembull, një aktor i keq si [presidenti rus, Vladimir] Putin vendos t'u japë robotëve aftësi për të krijuar qëllimet e tij", ka thënë Hinton. Shkencëtari kryesor në Google, Jeff Dean, ka thënë se kompania "mbetet e përkushtuar për një qasje të përgjegjshme ndaj inteligjencës artificiale". "Ne po mësojmë vazhdimisht t'i kuptojmë rreziqet në zhvillim", ka thënë ai.

## India thyen rekord me numrin e pasagjerëve ajrorë

**NEW DELHI, 2 MAJ** - Trafiku i brendshëm ajror i Indisë ka thyer rekordin me 4.56 milionë pasagjerë që kanë fluturuar brenda një dite. Rekordi është shënuar më 30 prill - në ditën kur në Indi janë realizuar 2 978 fluturime. "Rritja e trafikut të brendshëm

të pasagjerëve, pas periudhës së Covidit, reflekton rritjen ekonomike të Indisë", ka thënë ministri i Aviacionit, Jyotiraditya Scindia. Rimëkëmbja ekonomike e Indisë pas pandemisë ka nxitur një bum udhëtimesh. Më shumë se 37.5 milionë

pasagjerë janë transportuar nga linjat ajrore vendase vetëm në tre muajt e parë të vitit 2023. Kjo nënkupton rritje për 51.7% krahasuar me një vit më parë, tregojnë të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil të Indisë.



# Përkujtohet masakra e Studimes, aty ku policia dhe ushtria serbe masakruan 116 civilë të pafajshëm

24 vjet më parë, në Studime të Vushtrrisë, nga policia dhe ushtria serbe, u vranë dhe u masakruan 116 civilë shqiptarë të pafajshëm dhe të paarmatosur, burra, gra, djem dhe vajza. Paramilitarët serbë nuk kursyen as fëmijët dhe të moshuarit në planin e tyre për realizimin e gjenocidit në Kosovë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 MAJ - Përfaqësues të institucioneve të vendit, të pushtetit dhe të opozitës, kanë përkujtuar 24-vjetorin e masakrës së Studimes, aty ku policia dhe ushtria serbe patën masakruar 116 civilë të pafajshëm.

Presidentja Vjosa Osmani ka thënë se masakra e Studimes është dëshmi e gjenocidit të kryer nga Serbia në Kosovë. Në akademinë përkujtimore për masakrën e 2 majit në fshatin Studime të Vushtrrisë, Osmani ka thënë se historia nuk mund të rishkruhet. Ajo tha se institucionet do t'u gjenden pranë të gjithë atyre që kanë humbur më të dashurit e tyre nga regjimi serb. "Jemi këtu që të përkujtojmë 116 martirë të pafajshëm, përfshirë fëmijë e nëna shtatzëna. Jam këtu për t'ju thënë se dhimbja që keni përkujtuar atë ditë, është dhimbje e gjithëmbarshme. Masakra ishte organizuar nga regjimi serb. Sot duhet t'i përkujtojmë dhunën dhe masakrën e përjetuar dhe t'u gjendemi afër të gjithë atyre që humbën të afërmit e tyre. Kujtesa historike do të jetë në historinë tonë. Kjo që ka ndodhur këtu është argument se historia nuk mund të rishkruhet. Njerëz tanë u vranë vetëm pse ishin shqiptarë. Sot si asnjëherë duhet ta themi qartë se Serbia ka kryer gjenocid dhe pagja do të jetë e mundur vetëm kur kryerësit të dalin para drejtësisë", është shprehur Osmani.

I pranishëm në këtë akademi përkujtimore ishte edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, i cili ka thënë se Serbia kishte për qëllim ta shfarosë popullin shqiptar. "Kjo ishte një nga masakrat më të mëdha në Kosovë", ka thënë Konjufca. Kryeministri Albin Kurti përmes



një shkrimi në "Facebook" ka thënë se më 2 maj të vitit 1999, në fshatin Studime të Vushtrrisë, forcat serbe nxorën nga kolona dhe i pushkatuan 116 civilë shqiptarë. "Ekzekutuan fëmijë para syve të prindërve, vranë të rinj e pleq, edhe gra shtatzëna. Familjes Gërxfhalii ia vranë 36 anëtarë, nga moshën 85 vjeç deri në 5 vjeç", ka shkruar Kurti.

Ai ka thënë se e kaluara jonë është vendimtare për të tashmen dhe të ardhmen tonë. "Gjaku i derdhur për liri nuk shlyhet kurrë, siç nuk mund të shlyhen krimet e Serbisë në Kosovë. I bëj thirrje sistemit tonë të drejtësisë që të veprojnë për ndriçimin e së vërtetës. Dënime

për kriminelët e luftës dhe drejtësi për viktimat. Krimet e luftës nuk parashkruhen as vjetërsohen. Vuajtjet e popullit tonë janë të njoma përherë. I përjetshëm qoftë kujtimi për të gjithë martirët dhe dëshmorët e lirisë!", ka shkruar kryeministri.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, së bashku me bashkëpartiakë dhe djalin e ish-presidentit Hashim Thaç, Endritin, kanë bërë homazhe në fshatin Studime. Ai ka thënë se masakra e Studimes, krahas mbi 400 masakrave të tjera të realizuara në të gjithë Kosovën, janë dëshmitë më të fuqishme mbi atë se kush ishte agresori e

kush viktimat gjatë luftës së vitit 1998/99. "Përkundër kësaj, edhe sot, 24 vjet më pas, asnjë nga kriminelët serbë, ekzekutor apo urdhërdhënës, nuk ka dalë para drejtësisë vendore apo ndërkombëtare për të dhënë përgjegjësi për krimet e kryera. Për familjet e viktimave, ne si qytetarë të Kosovës, për shtetin tonë - një gjë është e sigurt: këto krime nuk do të vjetroheshin asnjëherë dhe ne nuk do të rreshtim së kërkuari drejtësi! Liria që gëzojmë sot ka në themele gjakun e mijëra martirëve të vendit tonë", është shprehur Krasniqi.

Edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, përmes një shkrimi në

"Facebook" ka përkujtuar këtë masakër. Ai ka thënë se plagët e popullit tonë janë ende të freskëta dhe nuk mund të mbyllen pa u ndëshkuar të gjitha krimet. "Në 24-vjetorin e rënies kujtojmë dhe nderojmë me përlujtë martirët e masakrës së Studimes së Vushtrrisë, që ranë për këtë tokë duke u shndërruar në gurë themeltarë të lirisë së vendit tonë. Ata u vranë vetëm pse ishin shqiptarë, vetëm pse aspironin lirinë e vendit. Nuk do të ndalemi derisa të dalin para drejtësisë autorët e krimeve. Lavdi e përjetshme të gjithë të rënëve për lirinë e Kosovës!", ka shkruar Haradinaj.

## Hoti: Kurti, një politikan që shkel mbi çdo gjë për ta ruajtur pushtetin




Prishtinë, 2 maj- Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, janë takuar të martën në Bruksel për një raund të ri bisedimesh për normalizimin e marrëdhënieve.

Zyrtarë të BE-së kanë konfirmuar se në agjendën e këtij takimi ishin dy çështje kryesore: miratimi i Deklaratës për të Zhdukurit dhe paraqitja e draftit të parë për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Për këtë takim ka reagu

deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, i cili ka thënë se sikur bisedat e së martës në Bruksel lidhur me Asociacionin të ishin pjesë e "marrëveshjes finale, ligjërisht të obligueshme, për njohje reciproke dhe normalizim të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë", ndoshta do t'i kishte kuptuar dhe arsyetuar qeveritarët aktualë. "Por, pa kurrfarë premtimi për njohje reciproke, e me gjithë atë dhunë që kreu aktual i qeverisë ka përdorur për të kundërshtuar asociacionin,

negocimi i statutit të asociacionit që ndodh sot në Bruksel është veprim i një politikanit që shkel mbi çdo gjë për të ruajtur pushtetin", ka shkruar Hoti në "Facebook". Ai ka thënë se, pavarësisht kësaj, dyshon se ka mundësi të arrihet diçka më e mirë se ajo që parashihet në marrëveshjen e vitit 2015, ku thuhet në mënyrë eksplicite se statuti i Asociacionit duhet ta marrë pajtimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës para se të miratohet nga qeveria.



# KMDLNj numëron shkelje të shumta të Gjykatës Speciale

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka thënë se Gjykata Speciale është jashtë çdo mbikëqyrjeje të ndonjë organizate për të drejtat e njeriut prandaj, “vetë prenë dhe vetë qepë, pa i dhënë llogari askujt”. Sipas KMDLNj-së, redaktimi i madh i aktakuzave dhe dëshmimeve e bën tërë procesin jotransparent dhe, thuajse, edhe sot është i pamundur të bëhet monitorimi i procesit gjyqësor përmes mjeteve elektronike. KMDLNj thekson se Specialja ka bërë përpjekje maksimale t’i denigrojë të paraburgosurit para opinionit me deklarata të papërgjegjshme të ish-prokurorit Smith sikur edhe me rastin e caktimit dhe të vazhdimit të paraburgimit. “Merren parasysh provat e sajara nga shërbimi informativ dhe kundërinformativ i Serbisë si dhe dëshmitarët e trajnuar në Serbi”, thuhet në shkrimin e KMDLNj-së

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 2 MAJ** - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) në një shkrim dërguar të martën medieve, me titull “Gjykata Speciale në Hagë, si gjykata e inkuizicionit në mesjetë”, ka theksuar se Gjykata Speciale me seli në Hagë u themelua dhunshëm në Kuvendin e Kosovës në kushte të një shantazhi dhe kërcënimi ndaj deputetëve. KMDLNj ka theksuar se pozita e

atëhershme e votoi këtë gjykatë që, “për ata që nuk shohin më larg se hunda, konsiderohet të jetë pjesë e sistemit juridik të Kosovës, ndërsa realisht nuk ka të bëjë asgjë me sistemin juridik të Kosovës përveç se të arrestuarit dhe të dënuarit janë shqiptarë, shtetas të Kosovës, kurse të gjithë të tjerët janë të huaj, ndërkombëtarë dhe shtetas të Serbisë”. “Kjo gjykatë është jashtë çdo mbikëqyrjeje të ndonjë organizate për të drejtat e njeriut prandaj, vetë prenë dhe vetë qepë, pa i dhënë llogari askujt. Rolin ‘monitorues’ i ka dhënë Komitetit Ndërkombëtar të

Kryqit të Kuq nga Gjeneva si dhe Ombudspesonit të Holandës që ka të drejtë të vizitojë të privuarit nga liria, shtetas të Kosovës, të gjithë shqiptarë. Shkeljet e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të theksuara, që nga intervistimi kur nuk tregonin se në çfarë cilësie ftohen në intervistim e deri te detyrimi i të intervistuarve që me vete të sjellin prova vetëfajësuese që janë në kundërshtim të plotë me të drejtat e njeriut”, thuhet në shkrimin e KMDLNj-së.

Sipas këtij institucioni, përkthimi i materialeve ka qenë selektiv dhe i pjesshëm që ka ndikuar në përgatitjen e mbrojtjes efektive. “Redaktimi i madh i aktakuzave dhe dëshmimeve e bën tërë procesin jotransparent dhe, thuajse, edhe sot është e pamundur të bëhet monitorimi i procesit gjyqësor përmes mjeteve elektronike. Mbyllja e procesit të gjykimit, në emër të mbrojtjes së dëshmitarëve, e humb çdo kuptim kur të dy dëshmitarët e parë në gjykimin kundër Thaçit dhe të tjerëve janë dëshmitarë rrethorë, njëri prej të cilëve është figurë mediatike. Realisht, asnjë dëshmitar, pavarësisht sa ‘mbrohet’, nuk është i panjohur për ata që po gjykohen, për ata që një kohë të gjatë janë marrë me çështje që po keqtrajtohen në këtë gjykatë dhe për një pjesë të opinionit shqiptar”, thekson

KMDLNj, duke shtuar se trajtimi shëndetësor i të paraburgosurve lë shumë për të dëshiruar, kurse vizitat “humanitare”, në raste të caktuara, ose nuk janë lejuar fare ose kanë qenë shumë nënçmuese. “Gjykata Speciale ka bërë përpjekje maksimale t’i denigrojë të paraburgosurit para opinionit me deklarata të papërgjegjshme të ish-prokurorit Smith sikur edhe me rastin e caktimit dhe të vazhdimit të paraburgimit me ç’rast del jashtë çdo logjike juridike dhe praktikave të gjykatave tjera të ngjashme duke refuzuar të gjitha kërkesat e avokatëve dhe duke futur në arsyetim edhe deklaratat në rrjete sociale të personave që nuk kanë të bëjnë fare me gjykatën por që këto deklarata i bëjnë ekskluzivisht për përfitime materiale”, thuhet në shkrimin e KMDLNj-së.

Më tutje në këtë shkrim thuhet se doli që Gjykata Speciale u raporton rregullisht Kombeve të Bashkuara (mund të përkthehet UNMIK-ut) ani pse nuk është themeluar nga OKB-ja ndërsa, në anën tjetër, nuk u raporton institucioneve të Kosovës ndonjë inkuizitorët e kësaj gjykate, kur duan ta arsyetojnë veten e sidomos pagat marramendëse, thirren se janë themeluar nga Kuvendi i Kosovës dhe se janë pjesë e sistemit juridik të saj. “Në rastin konkret, kjo gjykatë po sillet si Pako e Ahtisarit brenda sistemit juridik të Kosovës,

fjala e tyre është e fundit që nënkupton se është mbi vet shtetin e Kosovës. Qasje tipike kolonialiste dëshmohe kur urdhërohet bartja e një dosje gjyqësore të viti 2021 nga gjykatat e Kosovës.

Pastaj, për një kohë të gjatë fshihen provat shfajësuese për të akuzuarit kurse merren parasysh provat e sajara nga shërbimi informativ dhe kundërinformativ i Serbisë si dhe dëshmitarët e trajnuar në Serbi, po nga këto shërbime. Në mesin e këtyre dëshmitarëve ka edhe robër lufte nga Kosova që mbaheshin nga Serbia në burgje ku, në kushte frikësimi dhe dhune iu janë marrë ‘dëshmi’ inkriminuese për të akuzuarit. Në mesin e tyre ka edhe të tillë që sot bartin poste në institucionet kosovare”, thekson KMDLNj.

Sipas KMDLNj-së, nëse një gjykatë si kjo në Hagë që ka pretendime aq të mëdha merr si prova të mirëqena deklaratat e përfituesve apo, siç thotë Umberto Eko, të idiotëve të rrjeteve sociale, lirisht mund të themi se aty nuk mund të ketë drejtësi, se drejtësia ka vdekur apo është vlarë pikërisht nga ta që duhet të ndajnë drejtësi, në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht. “Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë mungesë vullneti, guximi dhe kredibiliteti, jo për të ndërhyrë në drejtësi por për të

## Chollet bisedon me Kurtin për “zbatimin e menjëhershëm” të Asociacionit

Prishtinë, 2 maj - Këshilltari i lartë i Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, një ditë para takimit të kryeministrit Albin Kurti me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në Bruksel, ka zhvilluar një bisedë telefonike me Kurtin. Në “Twitter”, Chollet tha se kanë biseduar edhe “për rëndësinë e zbatimit të menjëhershëm” të marrëveshjes për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.

Kurti tha se me Cholletin kanë diskutuar për agjendën e takimit të së martës. Në një komunikatë të lëshuar nga kabineti i tij thuhet, po ashtu, se Kurti theksoi rëndësinë e “zbatimit në tërësi dhe me mirëbesim” të Marrëveshjes Bazë për normalizimin e marrëdhënieve. Javën që shkoi Chollet njoftoi se ka

biseduar edhe me presidentin serb Aleksandër Vuçiq. Ngjashëm tha se kanë folur për “nevojën urgjente” për ta formuar Asociacionin.

Kurti dhe Vuçiqi u takuan për herë të fundit në Ohër më 19 mars, kur edhe u pajtuan gojariht për zbatimin e asaj që njihet si Marrëveshje Bazë, e që duhet të çojë drejt normalizimit të marrëdhënieve mes dy vendeve. Kjo marrëveshje, e njohur më herët edhe si propozimi evropian, kërkon nga të dyja palët që t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, i cili ka nisur qysh nga viti 2011.

Ajo nuk parasheh njohje të ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Serbisë, por kërkon prej tyre që të mos e pengojnë njëra-tjetrën në proceset integruese.



## Inflacioni në Evropë rritet para vendimit për normën e interesit



BLERIN, 2 MAJ - Inflacioni i dhembshëm i Evropës është rritur edhe më, duke shtuar rëndësinë ndaj ekonomive familjare dhe duke mbajtur tryshinë ndaj Bankës Qendrore Evropiane për të miratuar atë që mund të jetë një tjetër rritje e madhe e normës së interesit.

Çmimet e konsumit në 20 vendet e Bashkimit Evropian që përdorin valutën euro janë rritur për 7 për qind në prill, krahasuar me një vit më parë, një shifër pak më e lartë se shkalla e përvitshme prej 6.9-përqindësh në mars, ka njoftuar agjencia e statistikave e BE-së, Eurostat, të martën.

Inflacioni i çmimeve të ushqimeve është zbutur paksa, duke rënë në një shkallë vjetore prej 13.6-përqindësh nga 15.5 për qind sa ishte në mars, përderisa çmimet e energjisë pësuan rritje

më modeste prej 2.5-përqindësh, raporton AP.

Inflacioni bazë, i cili nuk përfshin ushqimin dhe karburantet, është ngadalësuar paksa, por ende ishte i lartë, prej 5.6-përqindësh, duke forcuar bindjen se BQE-ja do të vazhdojë fushatën e saj për mposhtjen e inflacionit me rritje të normës së interesit.

Analistët thonë se takimi i BQE-së, i paraparë për të enjten, në Frankfurt, mund të rezultojë me një rritje prej një çereku apo gjysmë pike të përqindjes.

Një ngritje e vogël do të ishte e moderuar në një varg rritjesh të shpejta nga banka, përderisa një ndryshim më i madh do t'i forconte shqetësimet se inflacioni ende nuk është rrugës së rënies drejt dypërqindëshit, që konsiderohet niveli më i mirë për ekonominë.

kërkuar që kjo gjykatë të jetë më transparente dhe e vendosur të respektojë të drejtat e personave të privuar nga liria e që po shkelen në mënyrë të lakuriqar dhe të turpshme. Deputetët e opozitës së sotme kanë problem të reagojnë sepse një pjesë e madhe e tyre e kanë votuar këtë gjykatë kurse pozita aktuale në kohën kur ishte votuar themelimi i kësaj gjykate, si opozitë kishte votuar kundër kurse sot po ndjehet mjaft mirë me punën e kësaj gjykate duke mos e ndërmarrë asnjë veprim për mbrojtje të të drejtave që iu takon. Madje, me disa veprime dhe deklarate po bënë përpjekje t'ua vështirësojë gjendjen”, thuhet në shkrimin e KMDLNJ-së.

Më tej theksohet se Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj, ndonëse kanë dënimin e plotfuqishëm, ende janë në Qendrën e Paraburgimit në Hagë. Në këtë drejtim, KMDLNJ thotë se askush nga institucionet e Kosovës nuk po kërkon që ata të transferohen

në Kosovë sepse të tilla janë kushtëzimet, bën të transferohen edhe në Serbi, por jo në Kosovë. “Po në të njëjtën kohë institucionet e Kosovës, Qendrën e Paraburgimit në Gjilan po e shndërrojnë në hotel për të dënuarit që janë në Danimarkë, asnjëri prej tyre nuk është danez, por nga shtetet e treta dhe të cilët shteti i Mbretërisë së Danimarkës ia shet Kosovës për një afat, fillimisht 10 vjet e që, në fakt, është një marrëveshje kriminale dhe raciste që deputetëve të Kuvendit të Kosovës po iu shitet si marrëveshje ndërkombëtare fitimprurëse. Tash, bëjeni një krahasim midis shtetasve të Kosovës që janë në Hagë e që duhet të trajtohen si pjesë e sistemit juridik të Kosovës dhe shtetasve jodanezë që do të trajtohen në Kosovë në bazë të ligjeve të Danimarkës. Çfarë poshtërsie!”, është theksuar në shkrimin e KMDLNJ-së.



## "Defender Europe 23" bën bashkë bendet ushtarake ShBA-FSK

GJILAN, 2 MAJ - Kori dhe Bendi i Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Evropë dhe Afrikë ka hapur turneun e tyre ballkanik në Gjilan të Kosovës, me një

performancë të shkëlqyer, si paraprirje e ushtrimit ushtarak fushor më të madh në rajon "Defender Europe 23", ku Kosova është nikoqire dhe pjesëmarrëse me mbi 1

300 pjesëtarë. Në bashkëpunim me bendin e FSK-së turneu do të vazhdojë më 3 maj në orën 17:00 në Shkollën e Muzikës "Prenk Jakova" në Gjakovë. "Ftojme

qytetarët e Gjakovës të marrin pjesë në këtë event, ku bendet e të dyja vendeve do të performojnë në mbështetje të ushtrimit 'Defender Europe 2'", ka njoftuar FSK-ja.



## GIZ-i i dorëzon MSh-së pajisje për menaxhimin e mbetjeve mjekësore në vlerë mbi 208 mijë euro

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 MAJ - Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) kanë nënshkruar të martën aktin e dorëzimit-pranimit të pajisjeve mjekësore për mbeturina mjekësore të cilat GIZ-u i ka siguruar për Ministrinë e Shëndetësisë. Në ceremoninë e këtij nënshkrimi ishin të pranishëm ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia dhe ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde, të cilët paraprakisht zhvilluan një takim, ndërsa nënshkrimi i dorëzimit-pranimit të pajisjeve u bë nga sekretari i përgjithshëm i MSh-së, Naim Bardiqi dhe drejtori i GIZ-it në Kosovë, David Oberhuber. Ministri Vitia tha se siguri i pajisjeve për mbeturina mjekësore është një kontribut i vlefshëm i Qeverisë së Gjermanisë përmes GIZ-it në



funkcion të menaxhimit më të mirë të mbetjeve mjekësore dhe ruajtjes së shëndetit publik. Ambasadori Joern Rohde tha se ky është një kontribut për ta ndihmuar menaxhimin e mbetjeve mjekësore, për të ndihmuar për një Kosovë më të shëndetshme dhe për ta përgatitur Kosovën për rrugën e saj për në Bashkimin Evropian. GIZ-i ka siguruar një numër të pajisjeve për menaxhimin e mbetjeve mjekësore të cilat do t'u dorëzohen 34 qendrave kryesore të mjekësisë familjare në komuna të Kosovës, sikurse edhe një transportuesi për bartje të mbeturinave mjekësore. GIZ, gjithashtu, në emër të Qeverisë Gjermane, është duke mbështetur Ministrinë e Shëndetësisë ta zhvillojë Planin për Menaxhimin e Mbeturinave Mjekësore (PMMM). Vlera e pajisjeve për menaxhimin e mbetjeve mjekësore nga GIZ-i për Ministrinë e Shëndetësisë është 208 675.00 euro.

## Zyrtarë të komunës së Prizrenit realizojnë vizitë në Iowa të ShBA-së

PRIZREN, 2 MAJ - Nënkryetari i komunës së Prizrenit, Kujtim Gashi dhe shefi i Kabinetit, Nehat Elshani, po qëndrojnë në Iowa të ShBA-së në kuadër të një delegacioni të disa komunave të Kosovës të udhëhequr nga MAPL-ja. Ata kanë zhvilluar takime me sekretarin e shtetit të Iowas, Paul D. Pate, përfaqësuesin e shtetit, Eddie Andrews dhe me zyrtarë të lartë të këtij shteti. Kohë më parë qytetin e Prizrenit e

ka vizituar një delegacion 40 anëtarësh i Iowas, me ç'rast është diskutuar për binjakëzimin e Prizrenit me qytetin "Council Bluffs", gjë që do të finalizohet nesër me nënshkrimin e marrëveshjes. Fillimi i miqësisë dhe vendosja e marrëdhënieve bilaterale do të sjellë përfitime për të dyja komunitetet, pasi do të zhvillohen projekte të përbashkëta në shumë fusha.



## Gjashtë raste të dhunës në familje në rajonin e Ferizajt

Ferizaj, 2 maj - Në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Ferizaj gjatë javës së kaluar, nga data 24-30/04/ 2023, janë raportuar gjashtë raste të dhunës në familje, prej tyre katër raste janë raportuar në Ferizaj, një rast në Shtime dhe një rast në Kaçanik. Me vendim nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, katër

persona janë ndaluar në mbajtje dhe dy të tjerë janë liruar në procedurë të rregullt hetimore. Policia Rajonale e Ferizajt rastet e dhunës në familje i ka trajtuar në mënyrë profesionale nga policë primarë të stacioneve dhe hetues rajonalë të Njësisë së Dhunës në Familje.

Policia u bën thirrje qytetarëve që t'i raportojnë rastet e dhunës në familje dhe i fton qytetarët të bashkëpunojnë me policinë. "Për të gjitha rastet e dhunës në familje ta njoftojnë menjëherë policinë, stacionin më të afërt apo përmes aplikacionit digjital 'Lajmëro Policinë'", ka njoftuar Policia e Kosovës.



## Ministri Mehaj vizitoi Ambasadën e Kosovës dhe të Shqipërisë në Kroaci

PRISHTINË, 2 MAJ - Me rastin e qëndrimit për vizitë zyrtare në Kroaci, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka vizituar Ambasadën e Republikës së Kosovës dhe të Shqipërisë. Me

këtë rast ai ka takuar ambasadorin Martin Berishaj dhe Riza Poda, të cilët e kanë njoftuar për angazhimet e Ambasadës, për bashkëpunimin e shkëlqyer

ndërmjet dy shteteve dhe shtetin partner Kroacinë, si aleat i besueshëm në fushën ushtarake dhe në mbrojtjen e vlerave demokratike. Gjatë këtyre vizitave ministri

Mehaj i ka falënderuar ambasadorët për angazhimin e tyre diplomatik në shërbim të interesave të kombit, të ruajtjes së paqes dhe të sigurisë së përgjithshme.



## Kundërshtohet heqja e emrit të Hasan Prishtinës nga UP-ja, kërkohet të tërhiqet rektori

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 MAJ - Fondacioni "Hasan Prishtina" dhe Shoqata Atdhetare Kulturore "Luma" nga Kukësi kanë mbajtur një aksion para Rektoratit të Universitetit të Prishtinës (UP) në shenjë reagimi ndaj idesë për heqjen e emrit të Hasan Prishtinës nga UP-ja. Profesori Shefqet Hoxha, përfaqësues i Shoqatës Atdhetare Kulturore "Luma", ka folur për jetën dhe veprën e Hasan Prishtinës, duke e quajtur çmenduri propozimin për heqjen e emrit të tij nga UP-ja. Madje, sipas tij, as populli nuk do ta pranojë një gjë të tillë. "Hasan Prishtina ishte organizator i

protestave të vitit 1915 dhe punoi përshtur për çlirimin e territoreve të Kosovës. Hasan Prishtina jeton në zemrat e kuksianëve. I lavdishëm qoftë kujtimi për të! Të hiqet emri prej këtij universiteti për mua është çmenduri, sepse është një prej figurave më të ndritshme të Kosovës dhe të Shqipërisë. Populli nuk do ta pranojë këtë gjë. Kategorikisht nuk duhet t'i hiqet emri Hasan Prishtina Universitetit të Prishtinës", ka thënë Hoxha. Ndërsa nipi i Hasan Prishtinës, Mehmet Prishtina, që përfaqëson edhe Fondacionin "Hasan Prishtina", i ka kërkuar rektorit të UP-së, Qerim Qerimi, të tërhiqet nga ky propozim dhe të merret me cilësinë në këtë institucion.



## Një delegacion nga Kuvendi i Kosovës po merr pjesë në programin "Open World" në ShBA



PRISHTINË, 2 MAJ - Një delegacion nga Kuvendi i Kosovës, në përbërje të deputeteve Arbëreshë Hyseni-Kryeziu dhe Fjolla Ujkani, si dhe nga administrata e Kuvendit, Agnesa Haxhiu, Visar Krasniqi dhe Labinot Smakaj, nën mbikëqyrjen e Laura

Bajrushit nga Ambasada e Amerikës në Prishtinë, po merr pjesë në programin "Open World" në ShBA. Fillimisht delegacioni qëndroi në Uashington, ku u takua me kongresistët Jim McGovern (Massachusetts), Marc Veasey

(Texas), si dhe me ndihmësin e kongresistit Ritchie Torres (New York). Delegacioni përmbylli aktivitetet në Uashington me takimin e realizuar me stafin administrativ të Komisionit për Mbikëqyrje dhe

Llogaridhënie. Programi po vazhdon me aktivitetet e radhës në Bismarck/North Dakota. Në këto aktivitete u përfshinë edhe takimet me senatorë të këtij shteti dhe personelin e tyre.

Qëllimi i këtij programi është shkëmbimi i përvojave në fushën e mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit dhe përfshirja e palëve të interesit në ligjëbërje. Vizita është mbështetur nga Ambasada e Amerikës në Prishtinë.

## Më 1 maj policia gjobiti 1 652 shoferë

Prishtinë, 2 maj - Policia e Kosovës ka njoftuar se më 1 maj ka shqiptuar 1 652 tiketa

trafiku. Kjo është bërë me dije në bazë të raportit 24-orësh të Policisë së Kosovës.

Po ashtu, është theksuar se janë evidentuar 41 aksidente trafiku. Prej këtyre, 18

aksidente me të lënduar dhe 23 të tjera me dëme materiale.





# Mospagesa e tatimit në pronë, Ibrahimimi: Qytetarët do të gjobiten me kamata dhe ndëshkime nga Ministria e Financave



**PRISHTINË, 2 MAJ** - Të gjithë qytetarët që nuk e kanë bërë pagesën e kështit të parë të tatimit në pronë nga 1 maji do të gjobiten me kamata dhe ndëshkime nga Ministria e Financave, ka treguar kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), Sazan Ibrahimimi, duke shtuar se niveli qendror nuk pati vullnet ta zgjidhë problemin e pagesës së këtij tatimi për qytetarët. “Problemi qëndron se niveli qendror nuk e zgjidhi këtë problem dhe tani ka kaluar afati ligjor për pagesën e kështit të parë të tatimit në pronë, ku qytetarët me automatizëm do të futen në sistemin e Ministrisë së Financave e ku do të llogariten gjoba dhe kamata, që do të fillojë me 10 për qind e pastaj me 0.65 për qind çdo muaj”, ka pohuar Ibrahimimi për “Telegrafin”, duke shtuar se qytetarët nga data 1 maj hyjnë

në sistemin e MF-së dhe ata që nuk e kanë paguar kështin e parë fillojnë të gjobiten me kamata dhe ndëshkime. Sipas tij, edhe pse u është premtuar qytetarëve të kenë falje 100 euro, kjo nuk ka ndodhur. “Niveli qendror nuk e ka vullnetin ta zgjidhë problemin. Premtoi shumë e në realitet nuk ndodhi asgjë. U premtua që do të bëhet një ligj që qytetarëve t’u bëhet falja, mirëpo nuk u dha asnjë shprehje që ai dëm i shkaktuar komunave kur do të kompensohet. Ishte i mbyllur hermetikisht e nuk i konsultoi komunat si hisedare pasi që preken buxhetet komunale”, ka thënë Ibrahimimi, duke theksuar se me veprimet e nivelit qendror, nëse zbatohet në mënyrë arbitrare falja e 100 eurove, ashtu siç është deklaruar ministri [i Financave], atëherë buxhetet komunale do të kenë

humbje prej miliona eurove. “Ne si Asociacion kërkojmë që këto humbje të kompensohen”, është shprehur ai. Ibrahimimi shton se kërkesa e kryetarëve të komunave është të mos ngriten faturat e tatimit në pronë dhe të jenë të njëjta si në vitin paraprak. “Kërkesa e kryetarëve të komunave ka qenë që të mos ngriten faturat e tatimit në pronë dhe të jenë të njëjta si në vitin 2022. Ne kemi kërkuar nga kryeministri [Albin Kurti] takim. Ndër temat do të jenë tatimi në pronë, falja dhe kompensimi. Takimi pritet të jetë më 15 maj. Shpresojmë që këtë kompensim ta bëjë Ministria e Financave. Këtë po e kërkojmë dhe nëse kjo nuk ndodh, atëherë do të shohim se çfarë do të ndodhë”, ka deklaruar Ibrahimimi. Ndërsa MF-ja ka sqaruar se tashmë Projektligji i ri për

Tatimin në Pronë është dërguar në Kuvendin e Kosovës dhe me këtë parashihet falja e 100 euro të faturave për vitin 2023. “Ne si qeveri veç se e kemi dërguar Projektligjin e ri për Tatimin në Pronë në Kuvend, i cili përmes një dispozite kalimtare mundëson faljen deri në 100 euro të faturave për vitin 2023, mirëpo Projektligji ende nuk ka kaluar të dyja leximet në Kuvend”, thuhet në sqarim. “Theksojmë që, bazuar në Projektligjin e Tatimit në Pronë, falja vlen edhe për qytetarët që tashmë kanë paguar faturën e tatimit në pronë dhe me rastin e hyrjes së ligjit në fuqi, pagesa që kanë bërë, u llogaritet si parapagim për kështet e tjera”, përfundon MF-ja. Pagesa e tatimit në pronë në Kosovë mund të bëhet në dy kështe. Afati për pagesën e kështit të parë është më 30 prill, ndërsa

për kështin e dytë është fundi i muajit shtator. Tatimi në pronë është taksë vjetore komunale dhe përcaktohet nga shumëzimi i vlerës së pronës me normën tatimore. Kjo normë është 0.15 për qind e vlerës së përgjithshme të pronës. Rritja e faturave të tatimit në pronë ka ndodhur pas vlerësimit të përgjithshëm të tokave dhe objekteve rezidenciale që ka bërë MF-ja në fund të vitit të kaluar. Pas këtij vlerësimi, tatimi në pronë për disa është rritur deri në 100 për qind e për disa ka mbetur i pandryshuar, pasi vlera e pronës, pas vlerësimit, nuk ka ndryshuar. Partitë opozitare në Kuvendin e Kosovës e kanë kundërshtuar rritjen e tatimit në pronë. Nga tatimi në pronë buxheti i Kosovës ka të hyra vjetore deri në 40 milionë euro.

## Ekzekutohen pagat për afër 2 000 punëtorë të platformës “Superpuna”

**PRISHTINË, 2 MAJ** - Platforma qeveritare “Superpuna” ka njoftuar se është bërë ekzekutimi i pagesës për rreth 2 000 punëtorët e angazhuar përmes “Superpuna” gjatë muajve shkurt dhe mars. Përmes një njoftimi në “Facebook”, “Superpuna” ka bërë me dije se bizneset që

angazhojnë punëtorë përmes “superpuna” duhet t’i kalojnë këto verifikime: T’i deklarojnë punëtorët e angazhuar në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK); T’i deklarojnë punëtorët në ATK me pagë të njëjtë apo më të lartë sesa në shpalljen në “Superpuna”; Të mos kenë obligime tatimore

të papaguara ndaj ATK-së. Subvencionimi nga qeveria bëhet me një muaj diferencë, ngaqë deklarimi i punëtorëve në ATK bëhet deri më 15 të muajit vijues të angazhimit. Pra, për punëtorët e angazhuar në muajin prill, deklarimi në ATK bëhet deri më 15 maj.



# Bill Clinton i telefonoi Hashim Thaçit në ditën e tërheqjes së ushtarit të fundit serb nga Kosova

E admiroj lidhshimin tënd dhe pres me padurim të takohemi, i ka thënë presidenti i SHBA-ve, Bill Clinton, liderit politik të UÇK-së, Hashim Thaçi, gjatë një bisede telefonike, më 20 qershor 1999, në ditën kur pjesëtari i fundit i forcave të mposhtura serbe prej 47 mijë trupash dhe 800 tankesh u tërhoqën nga territori i Kosovës.

Ai ka falënderuar Thaçin për bashkëpunim duke i thënë se do të punojnë së bashku edhe më tutje për vendosjen e paqes në vendin e çliruar, thuhet në dokumentin amerikan, që deri në vitin 2012 ka qenë jopublik.

Presidenti Clinton është shprehur i lumtur që forcat e Milloseviqit u larguan nga Kosova dhe që pas kësaj UÇK ka pranuar të transformohet në Trupat Mbrotjtëse të Kosovës.

"Urime për nënshkrimin e marrëveshjes për demilitarizimin dhe transformimin e UÇK-së. Jam shumë i kënaqur që kjo ndodhi në të njëjtën ditë kur forcat serbe kompletuan tërheqjen nga Kosova", ka thënë Clinton, gjatë kësaj bisede, e regjistruar nga Shtëpia e Bardhë.

"Faleminderit! Është një nder për neve që ju na uroni për demilitarizimin dhe transformimin e UÇK-së. Ky është edhe sukcesi juaj. Për neve ky është një kompromis për të punuar së bashku drejt paqes dhe stabilitetit në Kosovë dhe rajon", i ka thënë Thaçi, thuhet në dokument.

Atë ditë Clinton ndodhej për vizitë në Gjermani dhe Thaçit i ka telefonuar nga qyteti Keln, nga hoteli Hyatt, në ora 18:30.

"E di. Dhe të jam mirënjohës për këtë. Unë të siguroj se do të bashkëpunojmë plotësisht për të sjellë siguri, një forcë policore vendore, si dhe vetëqeverisjes të mirëfilltë për popullin e Kosovës. Kjo është një ditë e rëndësishme për



Kosovën. Jam shumë i lumtur që ia dolëm të ndalim spastrimin etnik të Kosovës", citohet t' i ketë thënë tutje Thaçit, presidenti amerikan.

Në vazhdim të bisedës Thaçi i thotë presidentit amerikan se ndalimi i spastrimit etnik është rezultat edhe i përpjekjeve të Clintonit dhe se përkushtimi për të punuar së bashku për paqe do të mbetet i njëjtë edhe në të ardhmen.

"Ne mund të garantojmë se do t'i respektojmë të drejtat e njeriut, të drejtat e minoriteteve në Kosovë. Jemi të përkushtuar për liri, paqe dhe demokraci për të gjitha grupet etnike në Kosovë. Ne po ashtu do të punojmë për ekonomi të lirë dhe të hapur. Biseda jonë e sotme do të jetë po ashtu një nxitje drejt këtyre qëllimeve", i ka thënë Thaçi presidentit të shtetit që udhëhoqi sulmet e NATO's mbi Serbinë.

Në vazhdim të bisedës Clinton vlerëson lartë përkushtimin e Thaçit për një Kosovë ku të gjithë do të jenë të barabartë pa dallim etnie dhe shpreh admirim për udhëheqjen e Thaçit.

"Do të kemi një të ardhme të mirë. Pres me padurim të takohemi dhe e admiroj lidhshimin tuaj", ka thënë

Clinton, thuhet në dokument.

"Faleminderit, zoti President! Beteja e re që na pret tani është kthimi i refugjatëve, rindërtimi, vendosja e shoqërisë civile, mbajtja e zgjedhjeve të lira dhe pluraliste. Ne do ta bëjmë këtë përmes mekanizmave tonë por gjithashtu me ndihmën dhe përkrahjen tuaj. Uroj të keni shëndet të mirë dhe sukses si në jetë ashtu edhe në punë", i ka thënë Thaçi në përmbyllje të bisedës.

Hashim Thaçi ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me presidentin Clinton, pastaj me presidentët Bush dhe Obama, si dhe me zëvendës presidentin Joe Biden i cili e ka quajtur edhe George Washington i Kosovës.

Raportet e mira me administratën amerikane, si kryeministër dhe president, Thaçi i vazhdoi edhe gjatë mandatit të presidentit Trump, deri ne shkuarjen e tij vullnetare në Gjykatën e Hagës, në vjeshtë të vitit 2020, pas akuzave, bazuar në raportin e Dick Martyt.

Procesi gjyqësor ndaj ish-presidentit Hashim Thaçi dhe krerëve tjerë të UÇK-së Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, vazhdon më 10 maj.

4817

THE WHITE HOUSE  
WASHINGTON  
June 25, 1999

MEMORANDUM OF TELEPHONE CONVERSATION

SUBJECT: Telcon with Kosovar Leader Hashim Thaçi

PARTICIPANTS: The President  
Kosovar Leader Hashim Thaçi

Interpreter: Lindita Imami  
Notetaker: Lindita Imami

DATE, TIME: June 20, 1999, 6:30 - 6:40 p.m.  
PLACE: Hyatt Hotel, Cologne, Germany

The President: Congratulations on the signing of the agreement for the demilitarization and transformation of the KLA. I am very pleased it happened on the same day that the Serb forces completed their withdrawal from Kosovo.

Kosovar Leader Thaçi: Thank you. It is an honor that you are congratulating us on KLA's demilitarization and transformation. This is also your success. For us it has been a compromise for the sake of working towards peace and stability in Kosovo and the region.

The President: I know. And I am grateful for this. I can assure you that we will fully cooperate to bring security, a local police force and true self-government for the people of Kosovo. This is a very important day for Kosovo. I am very pleased that we have managed to change the course of ethnic cleansing in Kosovo.

Kosovar Leader Thaçi: This process is also due to your efforts. We have in the past been committed and will continue to be committed to the peace process. We can guarantee that we will respect human rights, and minority rights in Kosovo. We are committed to bringing freedom, peace and democracy to all ethnic groups in Kosovo. We will also work for a free and open economy. Our conversation today will also be an incentive towards these goals.

CLINTON-LIBRARY PHOTOCOPY

2

The President: Your statement about respecting human rights and minority rights is very important. After the suffering of the people of Kosovo, for you to take the lead on these issues means to prove to everyone that our plight is just. Milosevic is not like the others. We will have a good future. I look forward to meeting you and I admire your leadership.

Kosovar Leader Thaçi: Thank you Mr. President. The new battle awaiting us now is the return of refugees, reconstruction, the establishment of a civil society and holding free and pluralistic elections. And we will do this through our mechanisms but also with your help and support. I wish you good health and success in both your life and work.

The President: Thank you. Good bye.

-- End of Conversation --

## Djali i heroit, thirrje shokëve të idealit të bacës Jakup: Anulojeni një vikend luksi e shkoni në Hagë

Djali i heroit të kombit, Abdullah Tahiri u ka bërë thirrje shokëve të idealit të bacës Jakup Krasniqi që të lënë luksin në fund të javës dhe të shkojnë në vizitë në Hagë.

"Pas vizitës së Isa Mustafës në Hagë, kam pritur që kthesën e madhe do ta bëjnë ish të burgosurit politik, shokët e bacës Jakup, ata të cilët me vite kishin qëndruar bashkë nëpër burgjet serbe.", kështu ka shkruar ndër tjera në "Facebook", Ilir Tahiri. Tahiri ka aluduar në shokët e idealit të bacës Jakup duke përmend emrin e Hydajet Hyseni

"Kur shohim e dëgjojmë se ish kreret e UÇK-së po i vizitojnë kongresmen, politikan, gazetarë, biznesmen, klerik fetarë e diplomat të rangjeve të ndryshme vendore e ndërkombëtare, lind



pyetja: pse nuk i shohim atje edhe të burgosurit politikë, si bacën Hydajet me shokë?!", ka pyet djali i heroit Avdullah Tahiri i vrarë në masakrën e Dubravës

Ndajeni një pagë, një vikend luksi në Shqipëri, apo një pushim modest dhe shkoni te baci Jakup në Hagë.

Pas vizitës së Isa Mustafës në Hagë,

kam pritur që kthesën e madhe do ta bëjnë ish të burgosurit politik, shokët e bacës Jakup, ata të cilët me vite kishin qëndruar bashkë nëpër burgjet serbe.

Kur shohim e dëgjojmë se ish kreret e UÇK-së po i vizitojnë kongresmen, politikaj, gazetarë, biznesmen, klerik fetarë e diplomat të rangjeve të ndryshme vendore e ndërkombëtare, lind pyetja: pse nuk i shohim atje edhe të burgosurit politikë, si bacën Hydajet me shokë?!

E kuptueshme që nuk ka qenë e lehtë t'i bashkohesh Jakup Krasniqit në luftë, ama jo shumë e kuptueshme të mos të gjinden dy ditë kohë për ta vizituar atë në Hagë. E kuptueshme që vizita ka kosto financiare, ama nuk e besoj që është aq e papërbalueshme sa të

mos mund të mbulohej, kur shumicën e shokëve të tij i shoh duke bërë pushime luksoze 2-3 herë gjatë vitit.

Baca Jakup, si gjithë të tjerët që po qëndrojnë atje, nuk është se nuk ka bërë mjaftueshëm për shokët e tij. Secili ish i burgosur politik që ka trokitur në derën e tij gjatë kohës sa Baci ka qenë në pushtet, për secilin hall që kanë pasur u ka gjetur zgjidhje.

Prandaj, mjafton ta ndani një pagë mujore të një familjari të punësuar ose një pjesë të shumës të cilën qeveria e Kosovës ua ka kompenzuar për qëndrimin në burgjet serbo-jugosllave dhe me atë shumë apo pagë mund ta realizoni vizitën.

Shkoni sepse atje do të merrni forcë dhe zemër.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Kosova mëson kundërshtarët në Ligën e Kombeve

### “Epoka e re”

**NION, 2 MAJ** - Në selinë e UEFA-s në Nion është bërë tërheqja e shortit për edicionin e parë të Ligës së Kombeve në konkurrencën e femrave. Ky format i ri do të zhvillohet në tri liga, e ku skuadrat pjesëmarrëse janë ndarë në vazot e shortit sipas pozicioneve të tyre në renditjen e koeficienteve të publikuar pas përfundimit të fazës së grupeve të kualifikimeve për Botërorin 2023. Kosova bën pjesë në Ligën C, teksa në bazë të shortit ajo është tërhequr në Grupin C5, ku janë përfshirë edhe Maqedonia

e Veriut dhe Bullgaria. Liga C është e ndarë në pesë grupe, ku katër grupet e para kanë nga katër skuadra, ndërsa grupi ku është përfshirë Kosova është me tri skuadra. Fituesit e këtyre pesë grupeve do të promovohen në Ligën B, ndërsa tri skuadrat më të mira të pozitave të dyta nga pesë grupe do të luajnë në “play-off” kundër tri skuadrave më të mira të pozitave të dyta në grupet e Ligës B. Ndeshjet janë paraparë të luhen me 20-26 shtator, 25-31 tetor dhe 29 nëntor-5 dhjetor 2023. Në tërheqjen e shortit e pranishme ka qenë menaxherja për futbollin e femrave, Valbona Gashi-Uka.



## Fusha e 2 Korrikut po merr pamje tjetër

**PRISHTINË, 2 MAJ** - Fusha e skuadrës së 2 Korrikut nga Prishtina do të marrë pamje tjetër pas investimeve që po bëhen nga komuna e Prishtinës. Drejtori i Drejtorisë së sportit, Granit Rugova, ka inspektuar punimet në tribunën lindore të fushës së 2 Korrikut. Ai ka thënë se janë duke punuar intensivisht për rregullimin e saj. “Po punohet intensivisht në tribunën lindore të FC 2 Korriku, në një ndër klubet më të vjetra në Prishtinë. Trashëgimia sportive e kryeqytetit tonë është çerdhe e talentëve të jashtëzakonshëm. Qysh në fillim të mandatit jemi zotuar se do t’i mbështetim klubet tona sportive në të gjitha format në misionin për ta shndërruar Prishtinën në qytet të sportit. Investimet dhe mbështetjet nuk do t’i ndalim”, ka shkruar Rugova.



## Batatina: Ndaj Dritës dua mbështetje masive

**PODUJEVË, 2 MAJ** - Skuadra e Llapit është duke e vazhduar garën për kualifikim në garat evropiane përmes Superligës së Kosovës, por kjo nuk është aspak e lehtë për faktin se ekipi që drejtohet nga trajneri Tahir Batatina renditet në vendin e gjashtë me 41 pikë, ndërsa përballjen e radhës e ka me skuadrën e Dritës në stadiumin “Zahir Pajaziti”. Trajneri Batatina u është drejtuar tifozëve me një mesazh ku u ka kërkuar mbështetje të

fuqishme për ta arritur synimin që është pozita e tretë në tabelë. “Shumë mund dhe sakrificë ka qenë për të arritur në këtë nivel. I lumtur dhe krenar që skuadra e Llapit ka këtë infrastrukturë sportive dhe një restorant të klubeve të nivelit evropian. Të enjten dua mbështetje masive sepse dy ndeshjet si vendas do të vendosin për Llapin e pozitës së tretë tabelore dhe pjesëmarrjes në garat evropiane”, ka shkruar Batatina në “Facebook”.



## Luiza Gega, e dyta në garën 5 kilometra rrugë në Itali

**TREVIZO, 2 MAJ** - Në aktivitetin sportiv të mbajtur në Oderzo të Trevizos në Itali, Luiza Gega ka qenë protagoniste në këtë ngjarje prestigjioze mes shumë emrave të rëndësishëm të atletikës botërore. Rezultatet fantastike të Luizës ndër vite kanë bërë që organizatorët italianë ta

përkrahin si “një yll të atletikës kontinentale”. Në këtë garë Luiza Gega mori pjesë në disiplinën 5 km rrugë. Atletja shqiptare u rendit në vendin e dytë me kohën 15.37 minuta, pas italianes Ludovika Kavali e cila e përshkroi këtë distancë për 15.35 minuta, një garë që u vendos në finish se cila do të ishte

fituesja. Synimi i atletes sonë kampione ishte ta thyente rekordin e saj personal, por terreni aspak favorizues dhe moti me shi nuk e mundësuan këtë gjë. Me datë 2 qershor në “Diamond League” do të jetë destinacioni i radhës i Gegës në disiplinën e saj të pëlqyer, atë të 3000 metrave me pengesa.



## Hamiltoni: Dua të qëndroj te Mercedesi sa më gjatë

LONDËR, 2 MAJ - Piloti britanik Lewis Hamilton, 7 herë kampion bote në Formula 1, duket se i ka idetë e qarta në lidhje me të ardhmen. Kontrata e tij me skuadrën e Mercedesit skadon në fund të këtij sezoni, por objektivi i tij është ta vijojë bashkëpunimin

me makinën gjermane. "Po mendoj për një plan afatgjatë. Nuk dua të qëndroj këtu te Mercedesi vetëm për një vit, por sa më gjatë", ka qenë deklarata e dhënë nga Hamiltoni pas garës së zhvilluar ditën e dielën në Baku. Deklaratë që tregon

qartë idenë e britanikut për të vijuar të qëndrojë te Mercedesi. Pra, duket se Hamiltoni është gati edhe për sezonin e 18 në Formula 1. Piloti 38-vjeçar duket se nuk ka alternativa të tjera edhe pse gjatë verës mund të dalë një ofertë më e mirë për të. Pritet

që ai të nënshkruajë një kontratë 1+1 me makinën gjermane. Përveç Mercedesit, vetëm Ferrari e Aston Martin janë dy ekipet e tjera që mund ta marrin pilotin britanik, pasi kalimi te Red Bulli është i pamundur. Problem është edhe rroga e madhe e



Hamiltonit, që vështirë se dikush do të paguajë për një 38-vjeçar, ndaj Mercedesi është mundësia e tij e vetme.

## Vladyslav Khomutov, 'Ylli i javës' në Superligë

PRISHTINË, 2 MAJ - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 31-të në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të FC Dukagjini, Vladyslav Khomutov. Çmimin "Ylli i javës" për futbollistit e KF Dukagjini, Vladyslav Khomutov, e ndau Valjeta Krasniqi, organizatore e eventeve në Albi Mall. Pasi mori këtë çmim për herë të parë, Khomutov u shpreh tejet i lumtur dhe falënderues për bashkëlojtarët, teksa pati falënderime edhe për të gjithë njerëzit në Kosovë për mbështetjen që po i japin vendlindjes së tij. "Jam shumë i lumtur për çmimin. Një falënderim i madh shkon për të gjithë bashkëlojtarët e mi sepse pa ta ky trofe do të ishte i pamundur. Falënderoj shtabin dhe të gjithë njerëzit e klubit. Në ndeshjen e fundit kishte një numër të madh të tifozëve të cilët na përkrahen.



Shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjithë njerëzit në Kosovë, të cilët e përkrahin vendin tim, Ukrainën, e cila po kalon në periudhë të vështirë si pasojë e agresionit të Rusisë. E falënderoj edhe familjen time për mbështetjen që ma bën nga Ukraina për çdo javë në çdo ndeshje. I kemi shumë të

rëndësishme 5 ndeshjet e fundit dhe do të luftojmë deri në fund që ta jetësojmë ëndrrën e KF Dukagjinit dhe të qytetit të Klinës për Evropë. Besoj se ne do të jemi një nga 4 ekipet të cilat do të garojnë në Evropë këtë edicion", ka theksuar Vlad Khomutov për faqen zyrtare të FFK-së.

## Denveri, tjetër leksion Phoenixit, Hardeni i dhuron fitoren Philadelphias

BOSTON, 2 MAJ - Denveri udhëheq 2-0 serinë e gjysmëfinale ndaj Phoenixit në Konferencën e Perëndimit pas fitores me rezultat 97-87. Një ndeshje ku skuadrat u mbrojtën mirë, por kjo nuk i pengoi vendasit ta kenë kontrollin e lojës e të fitojnë. Nikola Jokiq me 39 pikë e 16 rebounde ishte më i miri në fushë për Denverin, ndërsa për Phoenixin nuk mjaftuan 35 pikët e Bookerit dhe 24 të Durantit. Në Konferencën e Lindjes, skuadra e Philadelphias befaso i Bostonin,



duke fituar me rezultat 119-115 në gjysmëfinalen e parë jashtë fushës. Ndeshje me rivalitet deri në fund, ku për miqtë shkëlqeu James Hardeni, autor i 45 pikëve. "Mjekra" befaso i të gjithë me

paraqitjen e tij, mbështetur edhe nga Maxey me 26 pikë, ndërkohë që mungoi Embiid i dëmtuar. Për Bostonin, Tatum realizoi 39 pikë e 11 rebounde, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen.

### KONFERENCA E LINDJES - "PLAY-OFF" - GJYSMËFINALE

Boston - Philadelphia  
New York - Miami

115-119 (0-1)  
(0-1)

### KONFERENCA E PERËNDIMIT - "PLAY-OFF" - GJYSMËFINALE

Denver - Phoenix  
Golden State - Lakers

97-87 (2-0)

### SHKURT

#### Shqiponja, kampione te kadetet

Shqiponja është kampione e Kosovës në hendboll në grupmoshën e kadeteve. Shqiponja e Gjakovës e mbylli kampionatin me 31 pikë, përkatësisht me 15 fitore, një barazim e dy humbje. Shqiponja la prapa Ferizajn me 27 pikë. Pas Ferizajt u renditën Kastrioti e Istogu me nga 24 pikë. Me 23 pikë kampionatin e përfundoi Vushtrria. Të dielën në ndeshjen e fundit, Shqiponja e Ferizaj barazuan 27:27. Orgesa Gola i shënoi dhjetë gola për Shqiponjën, ndërsa gjashtë Jonesa Bajrami. Verona Hasanaj i realizoi pesë gola, katër Medina Musa. Te Ferizaj, Mirjeta Dinolli i shënoi shtatë gola. Gjashtë i shënoi Sumea Sadiku, ndërsa pesë Olsa Hoxha. Gjatë kampionatit ka pasur ndeshje interesante e me cilësi të mirë. Në skenë kanë dalë hendbolliste të reja, që janë e ardhmja e hendbollit kosovar.

#### Ronaldo mendon largimin nga Arabia Saudite

Cristiano Ronaldo dëshiron të largohet nga Al Nassri dhe të bëjë një rikthim të madh në Evropë. Ronaldo iu bashkua Al Nassrit në janar 2023 pas përfundimit të kontratës së tij me Manchester Unitedin. 38-vjeçari arriti një marrëveshje jashtëzakonisht fitimprurëse, duke nënshkruar një kontratë deri në vitin 2025. Ai fiton 173 milionë funte në vit, por duket se mund të largohet nga Arabia Saudite. Sipas një raporti nga gazeta spanjolle "El Nacional", Ronaldo dëshiron të largohet nga Arabia Saudite dhe është gati të kthehet në një nga skuadrat e tij të mëparshme. Portugezi ka kontribuar për Al Nassrin për pesë muaj, duke shënuar 12 gola në 15 ndeshje për klubin.

#### Xavi: City e meriton tripletën

Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, e ka lavdëruar Manchester Cityn duke e quajtur skuadrën më të mirë në botë për momentin. Po ashtu, Xavi e ka vlerësuar edhe Pep Guardiola si trajnerin më të mirë. "Natyrshisht, kjo do të ishte fer. Sipas mendimit tim, është skuadra më e mirë në botë për momentin. E ka trajnerin më të mirë në botë dhe futbollit kualitativ që ata luajnë pasqyron për ne këtë gjë", ka thënë Xavi. City është në rrugë për ta fituar tripletën. Ka arritur në finale të FA CUP, ku do të luajë kundër rivalit të qytetit, Unitedit. Në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve, City do të luajë kundër kampionit në fuqi, Real Madridit dhe ka një pikë më shumë se Arsenali në Premier Ligë me një ndeshje më pak të zhvilluar.

#### Frosinone konfirmon rikthimin në Serinë A

Frosinone ka fituar zyrtarisht promovimin në Serinë A pasi ka mposhtur Regginan 3-1 për të kaluar 10 pikë larg vendit të tretë me tri ndeshje para mbylljes së sezonit të Serisë B. Frosinone aktualisht ka 71 pikë në 35 ndeshjet e ligës dhe vetëm Genoa e vendit të dytë, katër pikë prapa me tri ndeshje deri në fund, mund ta pengojë të fitojë titullin e ligës. Sezoni fitues i rikthimit në Serinë A është drejtuar nga trajneri Fabio Grosso, i njohur për shënimin e penaltisë së fitores së Italisë në finalen e Kupës së Botës të vitit 2006 kundër Francës. Frosinone tani është vendosur për herën e tretë në ligën e parë dhe të parën në katër vjet, pasi ra nga kategoria në fund të sezonit 2018/19 pasi përfundoi në vendin e 19 me 25 pikë.

## Sancho kërkon rikthimin në Gjermani

Transferimi i mesfushorit Jadon Sancho te skuadra e Manchester Unitedit dy sezona më parë nuk dha atë që pritej. 23-vjeçari anglez në sezonin e tij të dytë në "Old Trafford" ka realizuar në

total vetëm 11 gola, ndërkohë që kur luante me Borussia Dortmundin shënonte shumë më tepër. Për këtë arsye, Sancho po sheh mundësinë e largimit nga Manchester Unitedi dhe

kërkon të rikthehet në Gjermani. Sipas "Sky Deutschland", menaxheri i lojtarit ka kontaktuar me drejtuesit e Borussia për të diskutuar për mundësinë e

rikthimit të mesfushorit sezonin e ardhshëm. Sancho ka një kontratë deri në vitin 2026 me Manchester Unitedin dhe kostoja e tij është 50 milionë euro. Te Borussia duket nuk janë më të

interesuar për ta blerë lojtarin, por janë të gatshëm ta marrin në formë huazimi. Trajneri Ten Hag nuk e ka në formacionin titullar, ndaj lojtari kërkon një skuadër ku të luajë më shumë.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

### **DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT - PRIZREN**

Datë: 28.04.2023

RN00011562

Bazuar në nenin 20 paragrafi 1, të Ligjit nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 5, pika (d) të Ligjit nr. 03/L-068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Udhëzimit administrativ (MASHT) për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm nr. 151/2020 të datës 22.12.2020, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, shpall:

## **KONKURS**

**Pozita: Drejtor i shkollës**

**Në shkollat fillore, të mesme të ulëta:**

1. ShFMU "Pllanjanç" në Pllanjanç;

**Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidati/ja për të marrë pjesë në konkurs:**

1. Kandidati/ja i/e interesuar duhet t'i plotësojë këto kushte:

- 1.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 1.2. Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm dhe normativit për arsim profesional në fuqi:
  - 1.2.1. Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
  - 1.2.2. Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
  - 1.2.3. Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
  - 1.2.4. Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- 1.3. Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve;
- 1.4. Të ketë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASH sipas rekomandimit të KSHLM;
- 1.5. Të ketë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës:
  - 1.5.1. Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të lartë;
  - 1.5.2. Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët/et për drejtor/eshës në nivele tjera dhe
  - 1.5.3. Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për zëvendës drejtor/eshë.
- 1.6. Për shkollat profesionale të AAP dhe Qendrat e Kompetencës, kandidati/ja duhet jetë me përgatitje profesionale të profileve përkatëse të institucionit ku konkurren.
  - 1.6.1. Kandidati/ja duhet të posedojnë dhe dëshmojë dokumentet në vijim:
    - 1.6.2. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
    - 1.6.3. Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë.
      - 1.6.3.1. Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim, ofron dëshminë e diplomës Master në këtë fushë të studimeve.
    - 1.6.4. Kopjen e dokumentit të identitetit (ID).
    - 1.6.5. Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
    - 1.6.6. Dëshminë se nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
    - 1.6.7. Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor;
    - 1.6.8. Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike.
    - 1.6.9. Portfolion profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të këtij UA.
  - 1.7. Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar me paragrafin 1.7. të këtij neni, dorëzohet kopje fizike në zyrën dhe afatin e përcaktuar me konkurs publik.
  - 1.8. Kandidati/ja në një konkurs publik, ka të drejtë të aplikojë në një e më shumë shkolla. Në raste të tilla përgatit dokumentacion të ndarë për secilën shkollë ku aplikon.
  - Kandidati/ja ka të drejtë për informim për qasje në planin zhvillimor aktual të institucionit për të cilin aplikon dhe mënyrën e mbështetjes për të siguruar kopjen e planit zhvillimor;

### **Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale**

Portfolio profesionale shërben si instrument për paraqitjen e përvojës dhe aftësi profesionale të fituara dhe zhvilluara nga shkollimi paraprak apo përvoja profesionale. Përvoja profesionale e kandidatit mund të përfshijë përvojën e kandidatit si mësimdhënës, menaxher në proceset e ndryshme të arsimit, përvoja paraprake nga menaxhimi i institucioneve apo proceseve si dhe dëshmia e aktiviteteve të zhvillimit profesional. Përpos dokumenteve që kërkohen si dëshmi që kandidati/ja i plotëson kushtet e shënuara në Nenin për Kushtet që duhet ti plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs, ndër të tjera portfolio profesionale duhet të përfshijë këto elemente të rëndësishme:

1. Biografinë e shkurtër.
2. Konceptin e Planit Zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor, bazuar në pesë fushat e cilësisë së performancës së shkollës (5-10 faqe). Koncepti duhet të ketë 5–10 faqe tekst (minimum një faqe për një fushë të cilësisë) me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12, arial). Koncepti i PZH është pjesë përbërëse e intervistës që realizohet nga komisioni përzgjedhës.
3. Kopjet e noterizuara të diplomave (Master dhe Bachelor).  
përfundimin dhe realizimin e pjesëve të programit dhe demonstron shkathësitë e fituara.
5. Certifikatat që dëshmojnë përfundimin e suksesshëm të programeve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve si dëshmi tjera rreth realizimit të atyre programeve.
6. Letër motivuese për pozitën që aplikon.
7. Dëshmi për aktivitetet tjera në proceset e zhvillimit të arsimit (zhvillimi i kurrikulave, udhëheqja e programeve të zhvillimit profesional, pjesëmarrja dhe kontributi në konferenca, etj).
8. Dëshmi nga përvoja paraprake në menaxhim (shembuj të projekteve, shembuj të shkrimeve nga fusha e menaxhimit, shembuj të planeve për zhvillimin e institucionit edukativo-arsimor që janë zhvilluar dhe/apo implementuar me udhëheqjen apo kontributin tuaj konkret).
9. Dëshmi nga përvoja paraprake në mësimdhënie (shembuj të planeve të mësim, shembuj të projekteve, kopje të punimeve, mirënjohje, etj).
10. Letër referencë me përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake nga një institucion publik-kredibil, drejtpërdrejtë e lidhur me punën e kandidatit dhe për konkursin përkatës (*si Ministria e Arsimit dhe Shkencës, DKA, këshilli drejtues i institucionit edukativo-arsimor, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë dhe individë me të cilët ka punuar ngushtë në programe dhe projekte të ndryshme për arsim*).

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

1. Drejtori/esha i/e IEAAP, ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë:
  - 1.1. Përgatitjen e Planit Vjetor, Planit Zhvillimor të Institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
  - 1.2. Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim (SMIA) dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimit dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
  - 1.3. Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit;
  - 1.4. Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Kurrikulës;
  - 1.5. Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë të institucionit edukativo-arsimor si dhe mekanizmave tjerë të institucionit që kanë rol në vlerësimin e performancës së institucionit dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
  - 1.6. Bashkëpunimin me Këshillin Drejtues të institucionit edukativo-arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimitarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo-arsimor;
  - 1.7. Raporton së paku dy herë në vit para KDSH-së;
  - 1.8. Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucionin edukativo-arsimor, duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
  - 1.9. Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH);
  - 1.10. Çështjet e tjera që rregullohen përmes Ligjit për arsimin parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASH dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

Konkursi do të jetë i hapur 8 ditë kalendarike, e drejta për aplikim fillon nga data 29.05.2023 deri më datën 05.06.2023 që konsiderohet si dita e fundit dhe mbyllja e konkursit.

Aplikimet e dorëzuara pas afatit të parashikuar nuk pranohen dhe aplikimet me mangësi refuzohen. Udhëzime për aplikimin: Kërkesa (Aplikimi) për punësim gjendet në <https://kk.rkgov.net/prizren/category/konkurset-njoftimet/aplikacione/> si dhe në <https://konkursi.rkgov.net/jobs?servant=2>. Pas plotësimit sipas çdo pike të aplikimit, bashkëngjiti dokumentet të cilat kërkohen sipas konkursit dhe mund të aplikoni në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Komunën e Prizrenit. VËMENDJE: Aplikimet e pranuar pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar brenda afatit për dorëzimin e aplikimeve. Konkursi është i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu siç parashikohet nga Ligjislacionin në fuqi. Konkursi dhe rezultatet shpallen në web faqen e Komunës së Prizrenit.

Drejtorja e Arsimit në Prizren  
Drejtoresha/Luljeta Veselaj Gutaj



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren - Prizren Belediyesi

### DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT - PRIZREN

Datë: 25.04.2023

RN00011525

Bazuar në nenin 20 paragrafi 1, të Ligjit nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 5, pika (d) të Ligjit nr. 03/L-068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Udhëzimit administrativ (MASHT) për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm nr. 151/2020 të datës 22.12.2020, Drejtoria Komonale e Arsimit në Prizren, shpall:

## KONKURS

### Pozita: Drejtor i shkollës

#### Në shkollat fillore, të mesme të ulëta:

- ShFMU "Ibrahim Fehmiu" në Prizren - rishpallje
- ShMU "Gani Saramati" në Prizren - rishpallje
- ShFMU "Dy Dëshmorët" në Piranë - rishpallje
- ShFMU "Vëllezërit Frashëri" në Planejë - rishpallje
- ShFMU "22 Dëshmorët" në Randobravë - rishpallje
- ShFMU "Brigada 125" në Medvec - rishpallje
- ShFMU "Zef Lush Marku" në Velezhë - rishpallje
- ShFMU "Izvor" në Lubinjë e Epërme - rishpallje
- ShFMU "25 Maji" në Lubinjë e Poshtme - rishpallje
- ShFMU "Dëshmorët e Zhurit" në Zhur;
- ShFMU "Nazim Buduri" në Hoçë të Qytetit;
- Çerdhja në Lagjen Bajram Curri në Prizren - rishpallje

#### Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidati/ja për të marrë pjesë në konkurs:

- Kandidati/ja i/e interesuar duhet t'i plotësojë këto kushte:
  - Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
  - Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelin e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm dhe normativit për arsim profesional në fuqi:
    - 1.2.1. Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
    - 1.2.2. Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
    - 1.2.3. Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
    - 1.2.4. Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
  - Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënës sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve;
  - Të ketë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASH sipas rekomandimit të KSHLM;
  - Të ketë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës:
    - 1.5.1. Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të lartë;
    - 1.5.2. Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët/et për drejtor/eshës në nivele tjera dhe
    - 1.5.3. Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për zëvendës drejtor/eshë.
  - Për shkollat profesionale të AAP dhe Qendrat e Kompetencës, kandidati/ja duhet jetë me përgatitje profesionale të profileve përkatëse të institucionit ku konkurron.
    - 1.6.1. Kandidati/ja duhet të posedojnë dhe dëshmojnë dokumentet në vijim:
    - 1.6.2. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
    - 1.6.3. Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë.
      - 1.6.3.1. Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim, ofron dëshminë e diplomës Master në këtë fushë të studimeve.
    - 1.6.4. Kopjen e dokumentit të identitetit (ID).
    - 1.6.5. Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
    - 1.6.6. Dëshminë se nuk është nën hetim dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenjja që përfshijnë fëmijët;
    - 1.6.7. Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor;
    - 1.6.8. Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike.
    - 1.6.9. Portfolion profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të këtij UA.
  - Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar me paragrafin 1.7. të këtij neni, dorëzohet kopje fizike në zyrën dhe afatin e përcaktuar me konkurs publik.
  - Kandidati/ja në një konkurs publik, ka të drejtë të aplikojë në një e më shumë shkolla. Në raste të tilla përgatitje dokumentacion të ndarë për secilën shkollë ku aplikon.
  - Kandidati/ja ka të drejtën për informim për qasje në planin zhvillimor aktual të institucionit

për të cilin aplikon dhe mënyrën e mbështetjes për të siguruar kopjen e planit zhvillimor;

#### Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale

Portfolio profesionale shërben si instrument për paraqitjen e përvojës dhe aftësive profesionale të fituara dhe zhvilluara nga shkollimi paraprak apo përvoja profesionale. Përvoja profesionale e kandidatit mund të përfshijë përvojën e kandidatit si mësimdhënës, menaxher në proceset e ndryshme të arsimit, përvoja paraprake nga menaxhimi i institucioneve apo proceseve si dhe dëshmia e aktiviteteve të zhvillimit profesional. Përpos dokumenteve që kërkohen si dëshmi që kandidati/ja i plotëson kushtet e shënuara në Nenin për Kushtet që duhet ti plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs, ndër të tjera portfolio profesionale duhet të përfshijë këto elemente të rëndësishme:

- Biografinë e shkurtër.
- Konceptin e Planit Zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor, bazuar në pesë fushat e cilësisë së performancës së shkollës (5-10 faqe). Koncepti duhet të ketë 5-10 faqe tekst (minimum një faqe për një fushë të cilësisë) me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12, arial). Koncepti i PZH është pjesë përbërëse e intervistës që realizohet nga komisioni përzgjedhës.
- Kopjet e noterizuara të diplomave (Master dhe Bachelor).
- Certifikatat që dëshmojnë përfundimin e programeve të zhvillimit profesional në fushën e administrimit, menaxhimit dhe udhëheqjes, si dhe dëshmi tjera që elaborojnë përfundimin dhe realizimin e pjesëve të programit dhe demonstrojnë shkathhtësitë e fituara.
